

HISTORITË PËRBASHKËTA PËR NJË EUROPË PA KUFIJ



▶ Ndikimi
i Revolucionit
Industrial



▶ Zhvillimi
i Arsimit



▶ Të drejtat e njeriut
siç pasqyrohen në
historinë e artit



▶ Europa
dhe bota



universität
wien



Austrian Chairmanship
Council of Europe
November 2013 – May 2014
Présidence de l'Autriche
Conseil de l'Europe
Novembre 2013 – Mai 2014

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



UDHËRRËFYES

Mësimdhënia e historisë është e dobishme...
është faktor vendimtar në pajtimin, njohjen,
mirëkuptimin dhe besimin e ndërsjellë mes popujve.
(nga Libri i Bardhë mbi Dialogun Ndërkulturor
“Bashkëjetesa në barazi dhe dinjitet”)

BOTIMI ELEKTRONIK

Histori të përbashkëta është një libër elektronik interaktiv me lidhje të shumta të burimeve të jashtme. Është një bashkësi materialesh modele për mësimdhënie dhe mësimnxënie, kryesisht me synimin për t'u përdorur në përgatitjen e mësuesve. Është i përshtatshëm për çdo mënyrë të përgatitjes së mësuesve: kurse fillestare, të njëkohshme, të vazhdueshme, dhe të përditësimit të njohurive. Përmbajtja e këtij libri elektronik është hartuar posaçërisht në mënyrë të tillë që pjesë të ndryshme të tij të mund të përdoren nga grupmosha të ndryshme të nxënësve.

PROJEKTI NDËRQEVERITAR (2010-2014)

Histori të përbashkëta është produkti përfundimtar i një projekti ndërqeveritar, i cili merret me aspekte të historisë Europiane, të cilat kanë lënë gjurmët e tyre në tërë hapësirën Europiane – në të gjithë palët nënshkruese të Konventës Kulturore Europiane. Europeanët kanë bashkëndarë:

- ▶ ndërveprime apo shkëmbime të cilat kanë rezultuar në ndikime të ndërsjella;
- ▶ konvergjenca apo zhvillime paralele me ose pa kontakte sistematike;
- ▶ tensione dhe konflikte dhe proceset e tyre të pajtimit;



- ▶ zhvillime dhe transformime të përbashkëta për secilin rajon;
- ▶ procesin më të fundit të bashkëpunimit dhe ndërtimit European, duke bashkuar diversitetin e madh të kulturave dhe identiteteve.

Këto ndërveprime, konvergjenca, tensione dhe transformime, të cilat nuk kanë qenë as të drejtpërdrejta e as pa kontradikta, kanë ndikuar në një sërë fushash, përkatësisht të vlerave, artit dhe kulturës, demografisë, ekonomisë, shkencës dhe teknologjisë, stilit të jetës, planifikimit hapësinor dhe shumë fushave të tjera.

Libri elektronik, i cili është punë e përbashkët e mësuesve të historisë Europiane, eksploron ide në lidhje me konceptin e historive të përbashkëta.


KËSHILLI I EUROPËS NË FUSHËN E MËSIMDHËNIES SË HISTORISË

Një nga fushat e punës së Këshillit të Europës, që nga formimi i tij, ka qenë historia dhe mësimdhënia e historisë. Historia është parë si ndihmesë në arsimimin e qytetarëve të Europës dhe më tej. Siç theksohet në Konventën Kulturore Europiane të vitit 1954, mësimdhënia e historisë luan rol në kapërcimin e dallimeve dhe bashkuar njerëzit, duke krijuar në këtë mënyrë mirëkuptim dhe besim reciprok mes popujve të Europës.

Ky publikim pritet të japë ndihmesën për veprimtarinë në vazhdimësi të Këshillit të Europës në fushat e dialogut ndërkulturor dhe mësimdhënies dhe mësimnxënies së historisë, duke u mbështetur në Rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare, përkatësisht Dialogu ndërkulturor dhe imazhi i tjetrit në mësimdhënien e historisë (KM / Rek. (2011)6); Mësimdhënia e historisë në zonat në konflikt dhe pas-konflikt (Rekomandimi 1880(2009); Mësimdhënia e historisë në Europën e shekullit të 21-të (Rek.(2001)15).

Zgjeron dhe zhvillon konceptet dhe rezultatet e projekteve të mëparshme, të tillë si:

- ▶ puna për multiperspektivitetin, veçanërisht Multiperspektiviteti në mësimdhënien e historisë: udhëzues për mësuesit, nga Robert Stradling (2003);



- ▶ puna për data dhe ngjarje kyçe, të cilat ishin pikëtakime të rëndësishme në Historinë Europiane dhe që çoi në botimin me titull *Udhëkryqet e Historive Europiane – Këndvështrimet e shumëfishta në lidhje me pesë momente kyçe në historinë e Europës* (2006);
- ▶ puna në lidhje me imazhin e tjetrit në mësimdhënien e historisë, e cila ka vënë në dukje mësimdhënien e historisë së shoqërive europiane kulturalisht të ndryshme, duke sjellë si rezultat miratimin e Rekomandimit të KM / Rek. (2011)6.

Histori të Përbashkëta është botuar në vitin 2014, në 60-vjetorin e Konventës Kulturore Europiane.

ÇFARË KUPTOJMË ME HISTORI TË PËRBASHKËTA?

Për një kohë të gjatë qasja ndaj historisë është karakterizuar nga interpretime të njëanshme të ngjarjeve, kryesisht për shkak se historia dhe mësimdhënia e saj ka shërbyer dhe shpesh ende u shërben nevojave të identiteteve etnocentrike.

Thelbi i konceptit «histori të përbashkëta» mund të identifikohet në bashkëveprimin dialektik të të gjithë subjekteve të përfshira në një ngjarje historike . Kështu qasja e «historive të përbashkëta», merr parasysh të gjithë aspektet e një ngjarjeje historike, të gjithë ndërveprimet e saj, konvergjenat dhe konfliktet, dhe në këtë kuptim është qasja metodologjike më komplekse dhe produktive. Qasja lejon zbërthimin dhe interpretimin e stereotipave, miteve të identitetit, të vizioneve negative të tjetrit, rrjedhimisht, në këtë mënyrë, mund të çojë në një dialog ndërkulturor dhe drejt shndërrimit të konflikteve. Ajo e shpalos historinë në tërë kompleksitetin e vet.

Historitë e përbashkëta e vë theksin në përvojat e përbashkëta, se sa në interpretime të ndryshme të së njëjtës ngjarje. Ai eksploron idenë se historia juaj është edhe historia jonë, gjithashtu historia jonë është edhe historia e tjetrit, megjithëse nuk do të thotë se nuk është shumëfaktorëshe, rrjedhimisht “e përbashkët” nuk do të thotë “e njëjtë si”.

Ky projekt eksploron idetë e përbashkëta brenda botës së dallimeve dhe pranon të gjitha përvojat, duke përfshirë edhe konfliktet e përbashkëta. Gjithashtu, ai mund të perceptohet si shënjim i një hapësire të përbashkët, me përmasa gjeografike, historike dhe kulturore. Tri shqetësimet kryesore janë: ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit të shteteve anëtare në lidhje me trashëgiminë e përbashkët historike; ndihmesë në proceset e parandalimit të konfliktit



dhe pajtimit nëpërmjet njohjes më të mirë të ndërveprimeve dhe konvergencave historike; vazhdimi i shpërndarjes së informacionit në lidhje me rekomandimet e Librit të Bardhë mbi Dialogun Ndërkulturor “Bashkëjetesa në barazi dhe dinjitet”, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në vitin 2008.

“Histori të Përbashkëta” vë në veprim rekomandimet e Këshillit të Europës për mësimdhënien e historisë.

ÇFARË PËRMBAN LIBRI ELEKTRONIK?

Në vend të përpjekjes për të trajtuar këtë temë shterueshëm, u zgjodhën një numër temash të mundshme. Çdo temë, e cila mund të paraqesë interes për një numër të konsiderueshëm të shteteve anëtare, tashmë është dokumentuar mjaftueshëm dhe qartazi paraqet mundësi për të shpalosur ndërveprim, bashkëkërkime dhe transformime të përbashkëta – apo histori të bashkëndara.

Temat e përzgjedhura janë:

- ▶ Ndikimi i revolucionit industrial;
- ▶ Zhvillimi i arsimit;
- ▶ Të drejtat e njeriut siç pasqyrohen në historinë e artit;
- ▶ Europa dhe bota;

Për çdo temë, çështjet e përzgjedhura me kujdes sigurojnë njohuri të rëndësishme dhe interesante, si dhe e angazhojnë lexuesin në hulumtime historike përkatëse. Çdo temë përmban një bashkësi tematikash mësimore, të cilat u drejtohen grupmoshave të ndryshme. Këto janë burime ndihmëse për mësuesit në punën e tyre të mëtejshme për të shumëfishuar tematika të tjera, të cilat mund të përshtaten në përputhje me situatën e tyre mësimdhënëse.

Ky botim nuk do të kishte qenë i mundur pa mbështetjen financiare nga Ministria e Arsimit dhe Kërkimit Shkencor të Norvegjisë.

Libri elektronik interaktiv është i disponueshëm në adresën e mëposhtme:

<http://shared-histories.coe.int>

Photos: Shutterstock, Council of Europe
Layout: DPPD, September 2015
Printed at the CE

PREMS 139415

SQL

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, 28 prej të cilëve janë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE